



**Lotaria
e Kosovës**

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT
LOTO 7/39

Prishtinë, Shkurt 2013

Në bazë të nenit 13, pika 1, të Ligjit për lojërat e fatit Nr. 04/L-080, Drejtoria e Lotarisë së Kosovës në Prishtinë, Dardania – Kurrizi 15/17, me 26. 02. 2013 miratoi:

RREGULLAT E LOJËS SË FATIT LOTO 7/39

I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këto Rregulla përcaktohen kushtet e përgjithshme për organizimin e lojës së fatit Loto 7/39.

Neni 2

Loja e fatit Loto 7/39 (në vazhdim: loja Loto 7/39) është lojë me numra, ku tërheqja e numrave të kombinimit fitues bëhet përmes aparatit (mikserit).

Në lojën Loto 7/39 paraprakisht përcaktohet lartësia e fondit të fitimit në bazë të përqindjes së përcaktuar.

Neni 3

Për obligimet ndaj pjesëmarrësve, organizatori përgjigjet me të gjitha mjetet, nëse janë plotësuar kushtet të përcaktuara me këto Rregulla.

Për pagesën e fitimeve të lojës Loto 7/39 garanton Qeveria e Kosovës.

Neni 4

Këto Rregulla janë bazë për arritjen e marrëveshjes për pjesëmarrjen në lojën Loto 7/39. Marrëveshja, sipas paragrafit 1 të këtij neni, lidhet ndërmjet Lotarisë së Kosovës (në vazhdim: organizatori), në njërën anë, dhe pjesëmarrësit (lojtarit), në anën tjetër, në bazë të pranimet të kushteve të përgjithshme, të parapara me këto Rregulla, sipas shprehjes së lirë të lojtarit, me vetë aktin e pagesës së shumës së shkruar në vërtetimin e dhënë për lojën Loto 7/39.

Këto Rregulla (kushtet e përgjithshme) i obligojnë palët kontraktuese.

Neni 5

Pjesëmarrës në lojën Loto 7/39, konsiderohet personi i cili me organizatorin ka lidhur marrëveshje (kontratë) në bazë të nenit 4 të këtyre Rregullave, dhe si dëshmi posedon vërtetimin mbi pagesën (në vazhdim: vërtetimi), me kusht që përmbajtja e tij të jetë e regjistruar në CD para tërheqjes së numrave të kombinimit fitues, si dhe që shënimet kompjuterike në vërtetim dhe në CD të jenë identike.

Neni 6

Në bazë të nenit 18 të Ligji për lojërat e fatit, organizatori përcakton se Rregullat e lojës Loto 7/39 detyrimisht duhet të përmbajnë:

1. emrin dhe selinë e organizuesit,
2. emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës,
3. kushtet për pjesëmarrje në lojë,
4. vendin dhe territorin në të cilin organizohet loja,
5. çmimin për një kombinim të luajtur,
6. afatin e fundit të pagesës për pjesëmarrje në lojë,
7. shumën e përgjithshme të pagesës për një xhiro të luajtur,
8. lartësinë e fondit, ndarjen e tij dhe llojin e fitimeve,
9. përshkrimin e tiketës ndihmëse dhe vërtetimit,
10. mënyrën, procedurën, mbikëqyrjen e tërheqjes dhe verifikimin e fitimeve,
11. mënyrën e publikimit të shumës së fondit fitues, llojet e fitimeve dhe rezultatet e lojës,
12. mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve,
13. mënyrën e njohjes së pjesëmarrësve me Rregullat e lojës dhe
14. procedurën në rastin e revokimit të tërheqjes.

1. EMRI DHE SELIA E ORGANIZATORIT

Neni 7

Lotaria e Kosovës me seli në Prishtinë, Dardania-Kurrizi 15/17, është organizatore e lojës së fatit Loto 7/39.

2. EMRI, PËRSHKRIMI DHE KOHËZGJATJA E LOJËS

Neni 8

Loja Loto 7/39 organizohet në mënyrë të përhershme, sipas xhirove, dy herë në javë, dhe atë të mërkurën dhe të shtunën.

Në çdo xhiro të lojës Loto 7/39 tërhiqen 7 numra nga grupi i numrave prej 1 deri 39. Numri i tërhequr një herë nuk merr pjesë më tutje në tërheqjen e radhës (e mëtejshme). Kombinimin fitues e përbëjnë numrat e tërhequr të radhitur sipas rendit aritmetik.

Neni 9

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39 bëhen në sistemin on-line dhe atë përmes tiketës ndihmëse te plotësuar, ose me përzgjedhjen e rastësishme të numrave.

Neni 10

Te pagesa përmes sistemit on-line, në përdorim janë dy lloje te tiketave ndihmëse: tiketa ndihmëse e thjeshtë, për plotësimin individual të kombinimeve dhe tiketa ndihmëse sistem.

1. Në tiketën ndihmëse të thjeshtë gjenden dhjetë fusha të numrave.
Një fushë të bashkuar e përbën kolona me katror ku janë të shtypur numrat prej 1 - 39.
Çdo fushë e numrave, e plotësuar, paraqet një kombinim.
Në kombinimin individual pjesëmarrësi qëllon se cilët shtatë numra do të tërhiqen në xhiron përkatëse.
Tiketa ndihmëse e thjeshtë plotësohet duke shënuar në fushën e bashkuar individuale 7 numra me shenjën "X".
Në një tiketë ndihmëse të thjeshtë mund të luhen më së paku një e më së shumti dhjetë kombinime.
Në anën e djathtë të tiketës ndihmëse gjenden katrorët ku parashihet mundësia për të luajtur më shumë xhiro përpara (parapagimi) prej 2 deri për 8 xhiro dhe pjesëmarrja në lojën JOKER.
2. Në tiketën ndihmëse sistem gjendet vetëm një fushë e bashkuar e numrave prej 1-39 për të qëlluar numrat e tërhequr dhe përcaktimi i variantit të sistemit të plotë, si dhe shiriti kontrollues (kolona horizontale) me 10 katrorë me numrat e shkruar: 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17. Tiketa ndihmëse sistem plotësohet sipas sistemit të plotë në atë mënyrë që, në fushën e bashkuar, me shenjën "X" mund të luhen (plotësohen) 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, ose 17 numra si dhe shënohet numri përkatës në katrorin vijues (kolonën horizontale), varësisht nga varianti i luajtur i sistemit të plotë. Në anën e djathtë të tiketës ndihmëse sistem gjenden katrorët për të luajtur më shumë xhiro përpara (parapagim), si dhe për pjesëmarrje në lojën JOKER.
3. Kombinimet e thjeshta të numrave dhe ato sistem mund të luhen edhe me përzgjedhjen e rastësishme të numrave sipas kërkesës së lojtarit, të cilët i përzgjedh programi kompjuterik. Varësisht prej dëshirës së lojtarit, mund të luhet edhe loja plotësuese e Jokerit.
4. Zgjedhja e numrave kombinues, sipas mënyrës së përshkruar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të luhet për disa xhiro përpara (parapagim), prej 2 deri 8 xhiro përpara.

3. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË LOJË

Neni 11

Tiketa ndihmëse plotësohet pastër, me stilolaps, pa përmirësime dhe shënime të parregullta, pra në atë mënyrë që shenja "X" të mos e kalojë fushën e paraparë të katrorit, dhe me këtë të mos vihet në dyshim se cilit numër i takon shenja "X" (cilin numër e ka luajtur pjesëmarrësi).

Neni 12

Tiketa ndihmëse është ekskluzivisht mjet ndihmës dhe nuk mund të shërbejë si dëshmi për pjesëmarrje në lojë.
Dëshmi për pjesëmarrje në lojë përmes sistemit on-line është vetëm vërtetimi.

Neni 13

Vërtetimi merr pjesë në atë xhiro për të cilën shënimet kompjuterike janë të regjistruara në CD.

Neni 14

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39 pranohen përmes terminaleve on-line të organizatorit.
Pranimi i pagesës përmes sistemit on-line fillon me plotësimin dhe leximin e tiketës ndihmëse, kurse përfundon me regjistrimin e përmbajtjes së tiketës të plotësuar në CD, si dhe me dhënien e vërtetimit mbi pagesën.
Pagesa për Loto mund të bëhet edhe me zgjedhjen e rastësishme të numrave.

Neni 15

Gjatë pagesës për Loto, lojtarit i jepet vërtetimi që përmban këto shënime kompjuterike:

- logoja dhe emri i organizatorit,
- emri i lojës dhe numri rendor i xhiros,
- numri operativ i shitësit,
- numri i vërtetimit,
- kombinimet e luajtura,
- numri i Jokerit (nëse është luajtur-paguar),
- shuma e përgjithshme e pagesës,
- data e pagesës dhe koha e saktë e pagesës,
- numri kontrollues i vërtetimit.

Neni 16

Vërtetimet që nuk i kanë shenjat të përcaktuara në nenin 15 janë të pavlefshme.
Pjesëmarrësi i lojës Loto 7/39 është i obliguar që menjëherë pas pagesës ta verifikojë vërtetimin. Në të kundërtën, reklamacioni i mëvonshëm nuk vlen.

Neni 17

Organizatori është i obliguar që shënimet në CD, në afatin e duhur kohor, t'i deponojë dhe t'i ruajë në trezorin e Lotarisë së Kosovës në Prishtinë. Deponim me kohë i CD-së në trezorin e Lotarisë llogaritet deponimi që bëhet para fillimit të tërheqjes së numrave për xhiron e caktuar të lojës Loto 7/39.

4. TERRITORI NË TË CILIN ORGANIZOHET LOJA LOTO 7/39

Neni 18

Loja Loto 7/39 organizohet në territorin e Republikës së Kosovës.

5. ÇMIMI PËR NJË KOMBINIM TË LUAJTUR

Neni 19

Çmimin për një kombinim për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39, me vendim të posaçëm e cakton organizatori.

6. AFATI I FUNDIT I PAGESËS PËR PJESËMARRJE NË LOJËN LOTO 7/39

Neni 20

Pagesat për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39 pranohen deri në afatin që me vendim të posaçëm e cakton organizatori.

Për afatin e fundit të pranimit të pagesave, organizatori është i obliguar që t'i njoftojë palët (personat) e interesuar duke vendosur njoftime në çdo vendpajim.

7. SHUMA E PËRGJITHSHME E PAGESËS PËR NJË XHIRO

Neni 21

Pagesën e një xhiroje të lojës Loto 7/39 e përbën shuma e pranuar e pagesës në pajtim me shënimet në CD, që në afatin e duhur është deponuar në trezorin e organizatorit.

8. LARTËSIA E FONDIT TË FITIMIT, NDARJA E TIJ DHE LLOJET E FITIMEVE

Neni 22

Fondi i fitimit në lojën Loto 7/39 përcaktohet prej bazës të cilën e përbën shuma e përgjithshme e paguar nga neni 21 i këtyre Rregullave.

Fondi i fitimit i një xhiroje të lojës Loto 7/39 është 50% i bazës nga paragrafi 1 i këtij neni. Shuma e fondit të fitimit për një xhiro duhet të shpallet para tërheqjes së numrave.

Neni 23

Fondi i fitimit ndahet në këtë mënyrë:

- Për shtatë të qëlluara - 20%
- Për gjashtë të qëlluara - 20%
- Për pesë të qëlluara - 20%
- Për katër të qëlluara - 40%

Organizatori ka të drejtë, me vendim të posaçëm të caktojë fondin e garantuar të fitimit me shtatë të qëlluara, si dhe mundësin dhe mënyrën e organizimit të lojës plotësuese. Shuma e një fitimi përcaktohet në atë mënyrë që pjesa e fondit e ndarë për atë lloj fitimi përpjesëtohet me numrin e fitimeve të atij lloji.

Neni 24

Nëse në një xhiro nuk ka fitues me shtatë të qëlluara, atëherë i gjithë fondi për “shtatëshe” bartet në xhiron vijuese në fondin për “shtatëshe” (Jackpot).

Në rast se ka më shumë se një fitues me shtatë të qëlluara, atëherë fondi për shtatë të qëlluara ndahet në shuma të barabarta. Nëse në një xhiro nuk ka fitues me gjashtë të qëlluara, atëherë fondi për “gjashtëshe” bartet në xhiron vijuese në fondin për “gjashtëshe”.

Neni 25

Në lojën Loto 7/39 janë katër lloje të fitimeve:

1. fitimi i llojit të parë
 - nëse në vërtetim, në një kombinim, janë qëlluar të shtatë numrat e tërhequr (“7-she”),
2. fitimi i llojit të dytë
 - nëse në vërtetim, në një kombinim, janë qëlluar gjashtë nga shtatë numrat e tërhequr (“6-she”),
3. fitimi i llojit të tretë
 - nëse në vërtetim, në një kombinim, janë qëlluar pesë nga shtatë numrat e tërhequr (“5-she”),
4. fitimi i llojit të katërt
 - nëse në vërtetim, në një kombinim, janë qëlluar katër nga shtatë numrat e tërhequr (“4-she”).

9. PËRSHKRIMI I TIKETËS NDIHMËSE DHE VËRTETIMIT

Tiketa ndihmëse sistem

Neni 26

Tiketa ndihmëse sistem është mjet ndihmës dhe nuk mund të shërbejë si dëshmi për pjesëmarrje në lojë.

Në anën e majtë të tiketës ndihmëse sistem gjendet vetëm një fushë e bashkuar me numrat 1 – 39, tabela e sistemeve, që mund të luhen dhe shiriti kontrollues me dhjetë katrorë me numrat e shënuar prej 8 deri 17.

Në anën e djathtë janë katrorët për të luajtur më shumë xhiro përpara (parapagimi) dhe për pjesëmarrje në lojën JOKER.

Në çdo tiketë është i shënuar emri i organizatorit dhe emri i lojës.

Pjesa e prapme përdoret për dhënien e udhëzimeve për lojën, por mund të përdoret edhe për reklama të ndryshme.

Tiketa e thjeshtë ndihmëse

Neni 27

Tiketa e thjeshtë ndihmëse përmban, nga e majta në të djathtë, dhjetë fusha me numra, kombinime, ku janë të shtypur numrat prej 1 deri 39. Mbi fushat me numra është teksti LOTO 7/39 ON LINE si dhe numri i kombinimeve.

Në anën e djathtë të kombinimit të fundit janë numrat që shërbejnë për parapagim për: 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 xhiro dhe fjalët “PO” dhe “JO”, që shërbejnë për të treguar se a dëshironi të luani lojën JOKER.

Nën fushat me numra është emri i organizatorit, kurse në të djathtë gjendet bar-kodi dhe numri serik i tiketës.

Vërtetimi

Neni 28

Vërtetimi mbi pagesën është regjistruar në shiritin kompjuterik dhe përmban shënimet e cekura në nenin 15 të këtyre Rregullave.

10. MËNYRA, PROCEDURA, MBIKËQYRJA E TËRHEQJES DHE VËRTETIMI I FITIMEVE

Tërheqja e fitimeve

Neni 29

Tërheqja e kombinimit fitues të lojës Loto 7/39 bëhet publikisht para komisionit prej tre anëtarëve, të cilët i emëron organizatori. Njëri anëtar i komisionit është person zyrtar i autorizuar nga Ministria e Financave.

Me teknikën e tërheqjes së numrave operon punëtori i autorizuar nga organizatori.

Tërheqja bëhet në Prishtinë dhe transmetohet drejtpërsëdrejti në TV.

Në secilën xhiro tërhiqen shtatë numra prej numrave 1 – 39.

Në rastin kur aparati për tërheqjen e numrave për ndonjë arsye nuk punon dhe topthi nuk lëshon hapësirën për përzierje apo ndalet dhe bllokohet në cilindrin vertikal, nuk llogaritet si numër i tërhequr dhe kthehet në mikser. Në këtë rast komisioni merr vendim për vazhdimin e tërheqjes së numrave me dorë nga numrat e mbetur në aparat. Tërheqjen me dorë e bën një anëtar i komisionit, i cili i mbulon sytë me material që pamundëson të parët, i përzien numrat e mbetur dhe vazhdon me tërheqjen.

Puna e Komisionit rregullohet më qartë me rregullore të posaçme, të cilën e miraton organizatori.

Neni 30

Gjatë tërheqjes komisioni mban procesverbalin, të cilin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit.

Procesverbali duhet të përmbajë: vendin, kohën dhe shumën e përgjithshme të paguar për atë xhiro, kombinimin fitues (shtatë numrat e tërhequr), sipas radhës së tërhequr dhe sipas rendit aritmetik.

Vërtetimi i fitimeve

Neni 31

Fitimin ose fitimet i zbulon programi kompjuterik, kurse i vërteton Komisioni për vërtetimin dhe verifikimin e fitimeve në përbërje prej më së paku tre anëtarëve. Anëtarët e Komisionit i emëron organizatori. Komisioni është i obliguar që CD-në me shënimet për xhiron përkatëse ta deponojë në trezor më së voni një orë para tërheqjes së numrave. Pas kësaj, trezori mbyllet dhe ai duhet të ketë shifrën dhe dy çelësa. Shifrën e di vetëm Kryetari i komisionit, kurse dy anëtarët e tjerë të komisionit e kanë nga një çelës. Hapja dhe mbyllja e trezorit bëhet gjithmonë në praninë e të tre anëtarëve të komisionit.

Në bazë të pagesës së bërë (të dhënave në CD) dhe procesverbalit të tërheqjes për çdo xhiro, Komisioni vërteton shumën e përgjithshme të paguar, fondin e fitimit sipas

llojeve të fitimit, numrin individual të fitimeve sipas llojit dhe shumën e fituar për një fitim, dhe për këto është i obliguar të përpilojë procesverbalin.

Puna e Komisionit rregullohet më qartë me rregullore të posaçme, të cilën e miraton organizatori.

11. MËNYRA E SHPALLJES SË FONDIT TË FITIMEVE DHE REZULTATEVE TË LOJËS (VËRTETIMI I FITIMEVE)

Neni 32

Raporti për pagesën e një xhiroje të lojës Loto 7/39, shpallet para fillimit të tërheqjes publike të kombinimit fitues të asaj xhiroje.

Raporti jozyrtar i rezultateve të një xhiroje të lojës Loto 7/39 bëhet pas tërheqjes publike përmes TV.

Raporti i përkohshëm

Neni 33

Organizatori përpilon Raportin e përkohshëm për rezultatet e tërheqjes dhe shumën e fitimeve sipas llojeve për xhiron përkatëse të lojës Loto 7/39. Raporti i përkohshëm shpallet në gazetën “Koha ditore” dhe në faqen e internetit të organizatorit.

Ky raport konsiderohet i përkohshëm për numrin dhe shumën e fitimit për 7 dhe 6 të qëlluara.

Raporti i përkohshëm përmban:

- numrin rendor të xhiros,
- datën e tërheqjes të xhiros përkatëse,
- kombinimin fitues,
- shumën e paguar dhe fondin e fitimit,
- shumën e fondit të fitimit të caktuar për llojet e fitimeve,
- numrin e fitimeve dhe shumën e fitimeve sipas llojit,
- numrat e vërtetimeve të fitimeve me 7 dhe 6 të qëlluara,
- afatin për reklamacione dhe
- të dhëna të tjera që u nevojiten pjesëmarrësve në lojë.

Neni 34

Pjesëmarrësit në lojë në xhiron përkatëse, që kanë njërin nga fitimet, por numri i vërtetimit të paguar nuk është shpallur ose nuk është shpallur aq sa ka fitime në vërtetim, kanë të drejtë të bëjnë reklamimin-kërkesën deri në ditën e tërheqjes së xhiros vijuese në ora 16.00.

Reklamacioni i dorëzohet organizatorit me anë të postës rekomande, ose drejtpërdrejt në selinë e organizatorit në Prishtinë gjatë orarit zyrtar të punës.

Reklamacioni i pranuar pas kalimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet me afat të kaluar dhe nuk merret në shqyrtim.

Neni 35

Reklamacioni duhet të përmbajë:

- numrin rendor të xhiros,
- datën e tërheqjes së xhiros përkatëse,
- numrin e vërtetimit të paguar, numrin e kombinimeve dhe cili kombinim është bazë për reklamimin e paraqitur,
- pikën e shitjes ku është bërë pagesa,
- në çka bazohet reklamimi,
- emri, mbiemri dhe adresa e paraqitësit të reklamacionit.

Reklamacioni që përmban shënime të pasakta, konsiderohet i parregullt dhe nuk do të shqyrtohet.

Neni 36

Kërkesat e pranuar me kohë i shqyrton Komisioni për vërtetimin e fitimeve. Pas procedimit të procedurës së paraparë dhe vërtetimit të gjendjes faktike, Komisioni për këtë përpilon procesverbalin.

Raporti përfundimtar

Neni 37

Në bazë të Raportit të përkohshëm dhe procesverbalit nga neni 31 i këtyre Rregullave, përpilohet Raporti përfundimtar i xhiros përkatëse të lojës Loto 7/39.

Raporti përfundimtar përmban:

- numrin rendor të xhiros dhe datën e tërheqjes,
- shumën e paguar dhe fondin e fitimit,
- fondin e fitimeve sipas llojeve të fitimeve,
- numrin e fitimeve dhe shumën e fituar sipas llojeve të fitimeve,
- reklamacionet e bazuara dhe të pabazuara,
- ditën e fundit të pagesës së fitimeve,
- përmirësimet e gabimeve eventuale nga xhiroja e kaluar.

Raporti përfundimtar shpallet më së largu 7 ditë nga dita e shpalljes së Raportit të përkohshëm në gazetën “Koha ditore”.

Raportin përfundimtar e verifikon drejtori i Lotarisë së Kosovës.

12. MËNYRA DHE AFATI I PAGESËS SË FITIM

Mënyra e pagesës

Neni 38

Pagesa e fitimeve me 7 dhe 6 të qëlluara bëhet sipas Raportit përfundimtar në selinë e organizatorit.

Pagesën e fitimeve me 5 dhe 4 të qëlluara e bëjnë shitësit në pikat e shitjes pas shpalljes të raportit në sistemin on-line.

Neni 39

Gjatë pagesës së fitimeve pjesëmarrësi është i obliguar të dorëzojë vërtetimin e rregullt. Vërtetim i rregullt është ai i cili përmban të gjitha elementet e përshkruara në nenin 15 të këtyre Rregullave.

Me dorëzimin e vërtetimit, fituesi është i obliguar që, personit i cili bën pagesën, t'ia japë që ta shohë edhe dokumentin identifikues.

Tatimi në fitim

Neni 40

Tatimin në fitim në Loto e paguajnë personat që kanë realizuar fitim dhe kjo në lartësinë e përcaktuar me ligj. Bazë për tatimin në fitim është shuma e fituar.

Afati i pagesës

Neni 41

Pagesa e fitimeve bëhet në afat prej 60 ditësh, nga dita e shpalljes së Raportit përfundimtar. Dinamikën e pagesës së fitimeve me 7 të qëlluara e përcakton organizatori.

Fitimet e papaguara

Neni 42

Nëse fituesi nuk kërkon pagesën e fitimit në afatin prej 60 ditë nga dita e shpalljes së Raportit përfundimtar, organizuesi shumë e fitimeve të papaguara do ta bartë në një rën të xhirot e radhës të lojës Loto 7/39, ose do ta përdorë për fitime në lojërat e tjera.

13. MËNYRA E NJOFTIMIT TË PJESËMARRËSVE NË LOJË ME KËTO RREGULLA

Neni 43

Këto rregulla shpallen në gazetën “Koha ditore” dhe gjenden në të gjitha pikat e shitjes. Personave të interesuar për pjesëmarrje në lojën Loto 7/39, organizatori është i obliguar t’u mundësojë njoftimin me këto Rregulla, domethënë t’ua japë në shiqim..

14. PROCEDURA NË RASTIN E REVOKIMIT TË TËRHEQJES

Neni 44

Organizatori, për shkaqe të arsyeshme, mund të revokojë (shtyj) tërheqjen e caktuar, në përputhje me Ligjin mbi lojërat e fatit.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 45

Organizatori është i obliguar t’i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD më së paku një vit nga dita e tërheqjes së xhiros përkatëse, me përjashtim në rastet kur është hapur procedura gjyqësore për realizimin e së drejtës nga pjesëmarrja në lojën Loto 7/39. Në këtë rast organizatori është i obliguar që t’i ruajë shënimet e vërtetimeve në CD deri në përfundimin e procedurës gjyqësore.

Neni 46

Për zgjidhjen e kontesteve që dalin nga pjesëmarrja në lojën Loto 7/39 është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 47

Këto Rregulla hyjnë në fuqi ditën e shpalljes në gazetën “Koha ditore”.
Me hyrjen në fuqi të këtyre Rregullave nuk vlejné: Rregullat e lojës së fatit Loto 7 nga 39, Nr. 87 të datës 10.05.2010.

Nr.92
26.02.2013.

Lotaria e Kosovës
Bashkim Sllamniku, Drejtor